



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BULQIZË

FTESË PËR DËGJESËN PUBLIKE PËR FAZËN E II-të TË VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR (VSM), NË KUADËR TË HARTIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR PËR BASHKINË BULQIZË

Më datë 29.05.2019 ora 11⁰⁰ tek Qendra Kulturore, Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Bulqizë ju fton të merrni pjesë në dëgjesën publike të fazës së II-të me qëllim informimin dhe diskutimin rreth Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Gjatë dëgjesës publike, “Gjeokonsult” studioja konsulente e hartimit të këtij plani së bashku me ekspert mjedisor do të prezantojnë materialin e Raportit paraprak të VSM-së :

- Raporti paraprak i VSM – së do të përmbajë informacione mbi ndikimet mjedisore, ekzistenca dhe pasojat e tyre pasi ajo përfshin një vlerësim gjithpërfshirës, sistematik dhe transparent i aspekteve mjedisore, sociale dhe ekonomike si dhe implementimet ne planifikim.

Konsultimi me banorët e Bashkisë Bulqizë dhe të gjithë palët e interesuar është thelbësore në hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për njohjen dhe diskutimin e raportit në lidhje me cilësinë dhe rezultatet e VSM-së dhe rekomandimet rreth tyre.

Ju lutemi të merrni pjesë në këtë dëgjesë, pasi opinionet dhe idetë tuaj janë tepër të vlefshme për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm për vitet e ardhshme duke siguruar një shfrytëzim të potencialeve dhe plotësimin e nevojave të qytetarëve.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet tuaja !

